



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/70

Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ për vitin 2016 t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/70

Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19, 51 dhe 52 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për Planifikim Strategjik i cili do të drejtojë procesin e Sistemit të Planifikimit të Integruar në Kosovë, dhe do të ketë përgjegjësinë e vendimmarrjes për:
 - 1.1. Planifikimin e politikave prioritare para se këto të paraqiten për vendimin përfundimtar të Qeverisë, duke përfshirë:
 - 1.1.1 përcaktimin e prioriteteve strategjike të qeverisë dhe shqyrtimin e nismave të politikave të reja para dorëzimit për shqyrtim në Qeveri;
 - 1.1.2 monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe ri-shqyrtimin e prioriteteve sipas nevojës;
 - 1.1.3 monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe lidhjen me prioritetet e tjera për zhvillim;
 - 1.1.4 strategjitë sektoriale/ndër-sektoriale;
 - 1.1.5 politikat fiskale dhe kornizën makroekonomike;
 - 1.1.6 përcaktimin e kufijve agregatë dhe sektorial të KASH-it dhe buxhetit vjetor;
 - 1.1.7 finalizimin e KASH-it dhe buxhetit vjetor para dorëzimit për miratim në Qeveri,
 - 1.1.8 shqyrtimin e çështjeve strategjike për investime publike dhe prioritetet për tu mbuluar nga ndihma e huaj;
 - 1.1.9 vendosjen e udhëzimeve të përgjithshme për Planin vjetor të punës së Qeverisë.
2. Komisioni për Planifikim Strategjik si anëtarë të përhershëm do të ketë përfaqësues nga:
 - 2.1. Kryeministri, Kryesues i Komisionit;
 - 2.2. Zëvendës Kryeministri;
 - 2.3. Ministri i Financave;
 - 2.4. Ministri i Integritimit Evropian;
 - 2.5. Ministra të tjerë, në vartësi të çështjeve që do të diskutohen.
3. Anëtarët e përhershëm të Komisionit për Planifikim Strategjik mund të zëvendësohen nga zëvendësit e tyre, me votë të plotë, nëse kjo pranohet nga të gjithë anëtarët e përhershëm të Komisionit.

4. Përgatitja e punimeve të Komisionit për Planifikim Strategjik do të mbështetet në nivel teknik nga Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik, në përbërje sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 11/19 të datës 18/03/2015.
5. Zyra për Planifikim Strategjik pranë ZKM, do të shërbejë si Sekretariat i Komisionit për Planifikim Strategjik, dhe do të jetë e ngarkuar me organizimin e mbledhjeve dhe përgatitjen e dokumentacionit përkatës sipas agjendës së Komisionit.
6. Komisionit për Planifikim Strategjik do të zëvendësoj Komisionin Qeveritar për Çështje Fiskale dhe Buxhet, i cili pushon se ekzistuar.
7. Me nënshkrimin e këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi Nr. 06/57 i datës 13.03.2009 për krijimin e Komisionit Qeveritar për Çështje Fiskale dhe Buxhet dhe Vendimi për krijimin e Komisionit për Investime Publike.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/70

Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW Frankfurt am Main ("KfW"), për projektin "Largimi i Ujërave të Zeza në Jug-Perëndim të Kosovës, faza IV", në Komunën e Pejës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/70
Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/54 të datës 24.10.2015, dhe në vend të z. Qazim Qeska anëtar në Bordin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi, Sh. A. Gjakovë emërohet z. Isuf Asllani.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/70

Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, 04/L-165, nr. 04/L-194, nenit 13 paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Financave që të aprovoj transfere nga nën-programi "Shpenzimet e paparashikuara" në ndonjë nën-program tjetër në Tabelat 3.1 dhe 4.1 për shumat individuale të kërkuara në vlerë prej 40,000 (dyzet mijë) euro për vitin 2016 të ndarjeve buxhetore.
2. Shuma e totalit të këtij autorizimi nuk mund të kaloj 20% (njëzet përqind) të shumës së ndarë vjetore të nën-programit "Shpenzimet e paparashikuara".
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/70

Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, 04/L-165 dhe nr. 04/L-194, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar për 74 gjyqtarë të krimeve të rënda për vitin 2016, në shumë prej 279, 720 euro. Shtesa mujore për gjyqtarët e lartpërmendur është 300 (treqind) euro. Mjetet ndahen sipas nën-programeve si në vijim:
 - 1.1. 22,680 euro për 6 gjyqtarë në Gjykatën Supreme dhe Dhomën e Posaçme me kod 316, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
 - 1.2. 30,240 euro për 8 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit me kod 380, kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje;
 - 1.3. 71,820 euro për 19 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Prishtinë me kod 381, kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje;
 - 1.4. 26,460 euro për 7 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Prizren me kod 382, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
 - 1.5. 26,460 euro për 7 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Gjilan me kod 383, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
 - 1.6. 26,460 euro për 7 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Ferizaj me kod 384, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
 - 1.7. 26,460 euro për 7 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Pejë me kod 385, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
 - 1.8. 26,460 euro për 7 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Gjakovë me kod 386, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
 - 1.9. 22,680 euro për 6 gjyqtarë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë me kod 387, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje;
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131, Kategoria ekonomike Rezerva.

3. Obligohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/70

Datë: 15.01.2016


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4) dhe neni 93 paragrafi 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Marrëveshjen për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të aprovuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 03/148 të datës 11.09.2013, duke mbështetur zotimet e përcaktuara në marrëveshjen e telekomunikacionit dhe afateve kohore për zbatimin e tyre, në përputhje me nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxori këtë:

V E N D I M

1. Udhëzohet Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) që të lëshoj autorizimin e përkohshëm dhe të kufizuar për ndërmarrjen e re "MTS" D.O.O. të regjistruar në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë tregtare (Gazeta Zyrtare Nr. 39 / 01 tetor 2008) të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare Nr. 6 / 22 korrik 2011) për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile, të kufizuar brenda operimeve të infrastrukturës siç përcaktohet me pikën 4 të Marrëveshjes për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
2. Udhëzohet ARKEP që në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive që ka për menaxhimin efikas të resurseve frekuencore dhe numerike, në zbatim të pikës 1) të këtij Vendimi, të caktoj resurse vetëm për aq sa është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, duke siguruar njëkohësisht ambient të përshtatshëm dhe pa interferenca për operatorët e autorizuar nga ARKEP, të cilët aktualisht ofrojnë shërbime të telefonisë mobile.
3. Autorizimi i përkohshëm i dhënë bazuar në këtë Vendim do të skadojë sapo autoritetet e Kosovës të lëshojnë një licence të re të plotë, të pa kufizuar, të telefonisë mobile, si rezultat i një tenderi apo ankandi.
4. Autorizimi i përkohshëm i dhënë bazuar në këtë Vendim do të hyj në fuqi në ditën e njëjtë kur ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve) ia alokon Kosovës kodin telefonik shtetëror siç përcaktohet në planin e Veprimit për zbatimin e Marrëveshjes për Telekomunikacionin në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/70

Datë: 15.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 05/24 i datës 17.04.2015 për Themelimin e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës, si në vijim: Pikës 2. të këtij vendimi i shtohen edhe 2 (dy) anëtarë, si më poshtë:
 - 1.1. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare;
 - 1.2. Këshilli i Investitorëve Evropian.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë